



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 10.05.2023

Nr: 89

Ora: 12:10

VENDIM

PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 55, DATË 08.05.2023 TË DEPOZITUAR NGA KOALICIONI "BASHKË FITOJMË"

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 10.05.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: Koalicioni "Bashkë Fitojmë"

OBJEKT:

1. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 452, datë 06.05.2023 "Për vlerësimin e raporteve të monitoruesve të fushatës zgjedhore për periudhën e monitorimit 7 mars deri 2 maj 2023";
2. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 456, datë 06.05.2023 "Për shqyrtimin administrativ të denoncimit



nr. 387 nga Partia Socialiste e Shqipërisë, për heqje të materialeve zgjedhore të vendosura në kundërshtim me ligjin nga koalicioni "Bashkë Fitojmë", në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023";

3. Ndryshimin pjesërisht të Vendimit të KSHZ nr. 452 datë 06.05.2023, duke vendosur:

a) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesat për mbylljen e zyrave zgjedhore të subjektit Koalicioni "Bashkë Fitojmë" në Bashkinë Tiranë, me vendndodhje: Rr. "Artan Lenja"; Rr. "Milto Tutulani"; Rr. "Margarita Tutulani", në Bashkinë Elbasanm e vendndodhje pranë Universitetit "Aleksandër Xhuvani";

b) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për mbylljen e zyrës së Partisë Demokratike në rrugën "Nasip Pallvo", pranë Liceut Artistik, për arsyen specifike sepse kjo zyrë nuk i takon subjektit zgjedhor PD të regjistruar në këto zgjedhje nga KQZ, por i takon entitetit politik që identifikohet me koalicionit Bashkë "Fitojmë" dhe për më tepër, kjo nuk është zyrë elektorale në kuptim të Kodit Zgjedhor, por është zyra e përhershme politike / selia e PD dega nr. 2 Tiranë;

c) Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me kërkesën për heqjen e materialeve propagandistike, në Bashkitë Durrës dhe Tiranë, në lidhje me subjektin Koalicioni "Bashkë Fitojmë", në shtylla ndriçimi, në rrugën "Veli Dedi, Bashkia Tiranë;

4. Ndryshimin e vendimit të KSHZ Nr. 456, datë 06.05.2023, duke vendosur: Pushimin e hetimit administrativ në lidhje me heqjen e menjëhershme të materialit ne propagandistik mbi fasadën e godinës së Postës Shqiptare në Kavajë, të subjektit Koalicioni "Bashkë Fitojmë".

BAZË LIGJORE: Nenet 21, 123/1, 124, 126, 129 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Koalicioni “Bashkë Fitojmë” ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 55 regj., datë 08.05.2023. Në mbledhjen e datës 10.05.2023, ora 12:10, pas relativitetit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 55 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 129, pika 3, shkronja “a” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 55, datë 08.05.2023, të paraqitur nga koalicioni “Bashkë Fitojmë”.
2. Shqyrtimi i kërkesës ankimore do të zhvillohet më datë 11.05.2023, ora 14:00.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk mund të bëhet ankim.

Koli	BELE	-	Relator
Elvin	LAKO	-	Anëtar
Elvis	ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan	RUSMALI	-	Anëtar
Ledio	BRAHO	-	Anëtar